



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
" HASAN PRISHTINA "
Fakulteti i Edukimit
Rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-229022 ëëë.uni-pr.edu
E-mail: edukimi@uni-pr.edu

Data: 25 Qershor 2018

Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave- Programi Parashkollor, Fillor dhe Pedagogji e përgjithshme

Komisionet e emëruara nga Dekanati i Fakultetit të Edukimit për shqyrtimin e ankesave në programet Parashkollor, Fillor dhe Pedagogji e përgjithshme, me datën 25 Korrik 2017 ka shqyrtuar ankesat e kandidatëve, të cilët kanë aplikuar për regjistrim në programin e lartëpërmendur dhe të cilët nuk e kanë fituar të drejtën për t'u regjistruar.

Gjithsej janë dorëzuar 28 ankesa në programi parashkollor, rreth 100 ankesa në programin fillor dhe 10 në programin e pedagogjisë së përgjithshme.

Gjatë shqyrtimit të ankesave, prezent ishin 17 kandidatë nga programi parashkollor, 57 kandidatë nga programi fillor dhe 6 nga programi i pedagogjisë.

I. Programi parashkollor

Në programin parashkollor u evidentuan 5 raste të gabimeve teknike në lexim optik të testeve, me ç'rast 3 kandidatë pas rikontrollimit të testeve nuk kaluan pragun minimal. Kandidati me numër aplikimi 100963 ka treguar rezultat total me 61.75 pikë me diference 0.05 nga kandidati i fundit i pranuar, prandaj propozohet të pranohet, kandidati 101278 pas rikalkulimit të pikëve rezulton të ketë 62.4 pikë dhe i plotëson kriteret për të qenë në listën e të pranuarve. Komisioni propozon që të merren parasysh këto dy raste.

Komisioni:

Blerta Perolli Shehu

Rozafa Ferizi Shala

Adhurim Rasimi

II. Programi fillor

Në programin fillor, rezultati i testit pranues të kandidati 101610, për shkak të shifrës së gabuar në fletën optike është kalkuluar me 0 pike përderisa në realitet është 55 pikë. Komisioni propozon që të pranohet për shkak se nese ky numër i pikëve në testin pranues kalkulohe me pikët e suksesit dhe të maturës, arrihet kriteri i pranueshmërisë. Poashtu propozohet pranimi i kandidatit me numër 100318, që ishte rasti i vetëm ku pikët në test pranues nuk i janë kalkuluar saktë. Me rishikimin e pikëve u vërejt se ky kandidat ka dy përgjigje të sakta më shumë në krahasim me rezultatin që i ka kalkuluar sistemi elektronik. Për kandidatin me numër 100978 që ka dallim 0.05 pikë dhe kandidatin me numër 101540 që ka dallim 0.1 pikë nga kandidati i fundit i pranuar komisioni gjithashtu propozon që të pranohen për shkak të dallimit shumë të vogël në pikë.

Komisioni:

Sedat Baraliu

Atdhe Hykolli

Edona Berisha Kida

III. Programi: Pedagogji e përgjithshme

Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk gjeti ndonjë ndryshim rezultatit, por, paraqet faktin se kandidati me numër aplikimi 100422, ka treguar rezultat total me 59.8 pikë me diference 0.05 nga kandidati i fundit i pranuar, prandaj propozohet të pranohet.

Komisioni:

Vlora Sylja

Valentina Nimonaj

Selim Qevani

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT
PRISHTINË

| | | | |
|-------------------------|-------|---------|-------|
| Pranuar me: 26. 7. 2018 | | | |
| Nj. org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 04 | 2356 | - | - |